



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONI RREGULLATOR

Data: 10.3.2025

Nr: 17

Ora: 14:30

VENDIM

PËR

NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 10, DATË 23.10.2024, TË KOMISIONIT RREGULLATOR “PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR REGJISTRIMIN E ZGJEDHËSVE NGA JASHTË TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE PËRGATITJEN E LISTËS SË ZGJEDHËSVE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 20, pika 1, shkronja “dh”, dhe nenit 25, pika 8, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Komisioni Rregullator

V E N D O S I:

- I. Në vendimin nr. 10, datë 23.10.2024, të Komisionit Rregullator “Për miratimin e rregullave për regjistrimin e zgjedhësve nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe përgatitjen e listës së zgjedhësve”, të ndryshuar, bëhet ky ndryshim:
1. Pika 12 e Kreut V ndryshohet si më poshtë vijon:

“12. Kur zgjedhësi që ka paraqitur kërkesë në listën e zgjedhësve që votojnë nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë vëren se nuk është i regjistruar në këtë listë ose regjistrimi i tij ka pasaktësi, ai ka të drejtë të paraqesë kërkesë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë deri 30 ditë përpara datës së zgjedhjeve. Kërkesa mund të paraqitet edhe *online* nëpërmjet një platforme elektronike të miratuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor. Kërkesa sipas kësaj pike përjashtohet nga taksa gjyqësore. Gjykata shqyrton dhe vendos për kërkesën, sipas kësaj pike, nëpërmjet kësaj platforme brenda 48 orëve nga data e regjistrimit të kërkesës. Emrit dhe të dhënave të tjera të zgjedhësit, që i shtohen listës së zgjedhësve që votojnë nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, i bashkëngjitet vendimi i Gjykatës.”.

- II. Ngarkohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe çdo organ tjetër i ngarkuar me detyra nga ky vendim, me zbatimin e tij.

Data: 10.3.2025 Nr: 17
Ora: 14:30



“Për një ndryshim në vendimin nr. 10, datë 23.10.2024, të Komisionit Rregullator “Për miratimin e rregullave për regjistrimin e zgjedhësve nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe përgatitjen e listës së zgjedhësve”, të ndryshuar”

- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
- IV. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit, Tiranë, brenda (5) ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

Ilirjana NANO Kryetar

Arens ÇELA Anëtar

Dritan ÇAKA Anëtar

Helga VUKAJ Anëtar

Muharrem ÇAKAJ Anëtar